



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.257/2 prot.

Datë 02.02.2024

V E N D I M

Nr. 129/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.02.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1306/2023, datë 14.12.2023 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. **REF-77239-08-10-2023**, me objekt **Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Blerje Tuba dhe Materiale konsumi laboratorike për nevoja të SRV” ndarë në 2 (dy) Lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, Loti 1 REF-77241-08-10-2023, Loti 1 “Blerje tubave/sistemeve të marrjes së gjakut” (në zbatim të kontratës koncesionare të laboratorëve), me fond limit Loti 1: 5,539,950 (Pesë milion e pesëqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Vlorë.**

Vazhdim i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës së operatorit ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ALMedical” SHPK në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Lënien të skualifikuar si edhe shtim të arsyeve të skualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK

Ankimues:

“Distributor of Medical Devices Group” SHPK me NIPT L81422033E dhe adresë Adresa: Njësia nr. 8, Rruga “Siri Kodra”, Objekti nr. 198-Tiranë.

Operatori ekonomik “ALMedical” SHPK me NIPT K21511002I dhe adresë Adresa: Rruga “Shefqet Musaraj”, Banesa nr. 17, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Spitali Rajonal Vlorë
Adresa: Lagjja “Partizani”.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 14.12.2023, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1306/2023, ku vendosi:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-77239-08-10-2023, me objekt **Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Blerje Tuba dhe Materiale konsumi laboratorike për nevoja të SRV” ndarë në 2 (dy) Lote -**

Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, Loti 1 REF-77241-08-10-2023, Loti 1 “Blerje tubave/sistemeve të marrjes së gjakut” (në zbatim të kontratës koncesionare të laboratorëve), me fond limit Loti 1: 5,539,950 (Pesë milion e pesëqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Vlorë.

2. *Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK, të korrigojë shkeljet e konstatuara, si dhe të kryejë veprimet procedurale në lidhje me zbatimin e konstatimeve të më sipërm.*
3. *Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “ALMedical” SHPK për procedurën e prokurimit më sipërcituar.*
4. *Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
5. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK.*
6. *Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifave financiare të paguara nga operatori ekonomik “ALMedical” SHPK.*
7. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
8. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 4970 prot., datë 21.12.2023, protokolluar me tonën nr. 2467/14 prot., datë 26.12.2023, autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Vlorë informon se: “Në përgjigje të vendimit tuaj nr.1306/2023 datë 14.12.2023 në lidhje me shqyrtimin e ankesës së operatorëve ekonomikë “Distributor of Medical Devices Group” SHPK dhe “ALMedical” SHPK, fillimisht personi përgjegjës i autorizuar në sistem ka kthyer procedurën nga procedurë e anuluar në procedurë në proces. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për arsye të mungesës së një prej anëtarëve të tij për shkak të marrjes së raportit për paaftësi në punë u zëvendësua me një anëtar të ri në SPE me UB nr.4916 datë 19.12.2023. Komisioni i Vlerësimit të ofertave pasi u akësua në sistemin e prokurimit publik shqyrtoi vendimin nr. 1314 të Komisionit të Prokurimit Publik dhe korigjoi arsyet dhe argumentet e konstatuara të cilat janë pasqyruar në procesverbalin e rivlerësimit. Bashkëlidhur këtij informacioni, të gjithë dokumentet e sipërmendur në lidhje me procedurën **Loti 1** “Blerje tubave/sistemeve të marrjes së gjakut” (në zbatim të kontratës koncesionare të laboratorëve).

-Procesverbalë i rivlerësimit me datë 21.12.2023.

-Urdhër i brendshëm nr.4912 datë 19.12.2023.

- Urdhër i brendshëm nr.4916 datë 19.12.2023.

-fotokopje të e-mail datë 19.12.2023.

I.3. Në datë 11.01.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 46/2024, ku vendosi:

1. *Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-77239-08-10-2023, me objekt **Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër: “Blerje Tuba dhe Materiale konsumi***

laboratorike për nevoja të SRV” ndarë në 2 (dy) Lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, **Loti 1 REF-77241-08-10-2023, Loti 1** “Blerje tubave/sistemeve të marrjes së gjakut” (në zbatim të kontratës koncesionare të **laboratorëve**), me fond limit Loti 1: 5,539,950 (Pesë milion e pesëqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Vlorë.

2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë procedurën e prokurimit të sipërcituar, referuar konstatimeve të vendimit nr. 1306/2023, datë 14.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik, për operatorin ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.4. Me shkresën nr. 358 prot., datë 23.01.2024, protokolluar me tonën nr. 2481/19 prot., datë 26.01.2024, autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Vlorë informon se: “Në përgjigje të vendimit tuaj nr.46/2024 në lidhje me zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 1306/2023 datë 14.12.2023 u kryen hapat e mëposhtëm:

-Fillimisht personi përgjegjës i autorizuar në sistem kaloi në fazën e rivlerësimit të procedurës në sistem.

-Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi u aksesua në sistemin e prokurimit publik, shqyrtoi vendimin nr.46/2024 të Komisionit të Prokurimit Publik duke rivlerësuar edhe njëherë procedurën në sistem sipas konstatimeve të vendimit 1306/2023 datë 14.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik për operatorin ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK, të cilat janë pasqyruar në procesverbalin e rivlerësimit”.

-bashkëlidhur procesverbali i rivlerësimit me nr. 355 prot., datë 23.01.2024.

-fotokopje të e-mail datë 19.12.2023.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën nr. 358 prot., datë 23.01.2024, protokolluar me tonën nr. 2481/19 prot., datë 26.01.2024, autoriteti kontraktor Spitali Rajonal Vlorë informon se: “Në përgjigje të vendimit tuaj nr.46/2024 në lidhje me zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 1306/2023 datë 14.12.2023 u kryen hapat e mëposhtëm:

-Fillimisht personi përgjegjës i autorizuar në sistem kaloi në fazën e rivlerësimit të procedurës në sistem.

-Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi u aksesua në sistemin e prokurimit publik, shqyrtoi vendimin nr.46/2024 të Komisionit të Prokurimit Publik duke rivlerësuar edhe njëherë procedurën në sistem sipas konstatimeve të vendimit 1306/2023 datë 14.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik për operatorin ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK, të cilat janë pasqyruar në procesverbalin e rivlerësimit”.

-bashkëlidhur procesverbali i rivlerësimit me nr. 355 prot., datë 23.01.2024.

-fotokopje të e-mail datë 19.12.2023.

II.1.1. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, në lidhje me zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, u konstatua se autoriteti kontraktor nuk ka kryer rivlerësimin për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi në përputhje me konstatimet në vendimet KPP. 1306/2023 datë 14.12.2023, duke rivlerësuar operatorin ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK vpjesëmarrës në procedurën e prokurimit të sipërcituar, referuar konstatimeve të këtij vendimi. Pra, nuk është bërë një zbatim i drejtë dhe korrekt i vendimit KPP. 1306/2023.

Konkretisht nuk është zbatuar plotësisht pika e dispozitivit:

“ Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK, të korrigjojë shkeljet e konstatuara, si dhe të kryejë veprimet procedurale në lidhje më zbatimin e konstatimeve të mësipërm”.

pasi anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Oferta nuk kanë kryer vlerësimin në mënyrë unanime në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në përputhje me konstatimet në vendimin KPP.1306/2023, datë 14.12.2023, për operatorin ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK.

Gjithashtu, Komisioni konstatoi se, në procesverbalin e rivlerësimit me nr. 355 prot., datë 23.01.2024, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në pikën 3, për artikullin 13 “Age flutur për marrjen e gjakut”, ka dërguar e-mail zyrtar kompanisë prodhuese më datë 19.12.2023, e cila nuk ka kthyer përgjigje në lidhje me informacionin e kërkuar. Në këto kushte, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka skualifikuar operatorin ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK.

II.1.2. Gjithashtu, Komisioni i Vlerësimit të Oferta është shprehur se ka vepruar duke iu referuar për analogji mënyrës se si KPP gjykon në të tillë rasti, konkretisht pika III.4 fq 37 të vendimit të sipërcituar. Në lidhje me këtë moment, Komisioni iu sqaron se, ju si Komision i Vlerësimit të Ofertave pasi keni keqinterpretuar shqyrtimin e këtij pretendimi. Konkretisht, referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, veprimeve procedurale të kryera nga KPP në parashikim të ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, Komisioni gjykon, se me dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “ALMedical” SHPK, ky i fundit nuk i përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.3, të dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-shqyrtimi, për arsye se në dokumentin e Deklaratës së konformitetit BE të prodhuesit Zhejiang Gongdong Medical Technology Co., Ltd me datë 11.0.2023, KPP konstaton, se në këtë dokument të përkthyer nga gjuha e huaj anglisht në gjuhën shqipe, citohet emri i produktit “Tub gjaku me vakum njëpërdorimsh, kodi i produktit IVR 0801 dhe kodi EMDN W050101 nga kompania

prodhuese “Zhejiang Gongdong Medical Technology Co., Ltd, i cili është prodhues zyrtar i materialeve laboratorike konsumi.

Duke genë se, operatori ekonomik “ALMedical” SHPK ka ofertuar për artikullin nr. 8 shoqëruar me dokumentacion “Deklaratës së konformitetit BE” të prodhuesit Zhejiang Gongdong Medical Technology Co., Ltd, në të cilin citohet emri i produktit “Tub gjaku me vakum njëpërdorimsh, kodi i produktit IVR 0801 dhe kodi EMDN W050101, ndërkohë referuar emërtimit të artikullit me nr.8 “ Set Age per marrje gjaku, të përshtatshme për të gjitha tubat e sistemit me vakum të ofruar” **nuk përputhet me emërtimin e produktit të deklaruar në dokumentin e “Deklaratës së konformitetit BE” nga kompania prodhuese “Zhejiang Gongdong Medical Technology Co., Ltd., dhe jo se ka mungesë marrje përgjigje me e-mail nga kompania prodhuese.**

II.1.3. Për sa më sipër cituar, Komisioni gjykon se, në lidhje me zbatimin e vendimit nr. 1306/2023, datë 14.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor nuk ka kryer hetim shterues në zbatimin të nenit 82 të VKM nr.295/2021. Pra, përveç kërkesave për sqarim që iu drejtohet palëve të treta, mund t’i drejtohet për sqarim edhe vetë ofertuesit në fjalë. Autoriteti kontraktor, duhet të rishikojë metodikën e kërimit dhe të japi sqarime faktike në lidhje me zbatimin e drejtë të procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenit 46 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar” me Nr. **REF-77239-08-10-2023**, me objekt **Objekti i kontratës / Marrëveshjes Kuadër:** “Blerje Tuba dhe Materiale konsumi laboratorike për nevoja të SRV” *ndarë në 2 (dy) Lote - Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë (një OE të vetëm të suksesshëm për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”, Loti 1 REF-77241-08-10-2023, Loti 1 “Blerje tubave/sistemeve të marrjes së gjakut” (në zbatim të kontratës koncesionare të laboratorëve), me fond limit Loti 1: 5,539,950 (Pesë milion e pesëqind e tridhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 25.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Vlorë.*

2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë procedurën e prokurimit të sipërcituar, referuar konstatimeve të vendimit nr. 1306/2023, datë 14.12.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik, për operatorin ekonomik “Distributor of Medical Devices Group” SHPK.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Kreshnik Ternova

Anëtar

Anila Malaj

Kryetar

Jonaid Myzyri

